



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 12, datë 21.10.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria” ; Mbledhje jashtë radhe (Ora 14²⁰)

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Vullnet Bilbilaj | 19.Atird Hoxha |
| 2.Edlira Kapllanaj | 20.Geron Gunbardhi |
| 3.Gjergji Nika | 21.Briseida Çakërri |
| 4.Edison Kapaj | 22.Grigor Dede |
| 5.Simo Petromilo | 23.Erëmal Arapi |
| 6.Englantina Imeraj | 24.Besmir Brahimi |
| 7.Novrus Rrokaj | 25.Shkëlqim Leskaj |
| 8.Elca Bezhani | 26.Arsen Belaj |
| 9.Eglantina Aliaj | 27.Roland Strakosha |
| 10.Endri Hyseni | 28.Vjola Xhafaj |
| 11.Frosina Qyrdeti | 29.Simbol Pazaj |
| 12.Evis Allushi | 30.Klodian Xhyheri |
| 13.Ervis Moçka | 31.Anxhela Shenaj |
| 14.Lorel Canaj | 32.Arjan Isufi |
| 15.Myzafer Elezi | 33.Eda Begaj |
| 16.Ardian Musta | 34.Rajmonda Zoto |
| 17.Eneida Vera | 35.Aurora Qarri |
| 18.Liri Dëma | 36.Elpiniqui Mërkuri |
| | 37.Liljana Breshani |

Mungojnë:

- 1.Illir Aliaj
- 2.Brikena Puka
- 3.Brikena Sika
- 4.Anisa Ceno
- 5.Mujo Shakaj
- 6.Sokol Kushta
- 7.Gëzim Çapoj
- 8.Dikens Bushaj
- 9.Refie Laze
- 10.Alta Haluci
- 11.Ledja Shollaj
- 12.Marsela Dashi
- 13.Jerina Dervishaj
- 14.Bujar Osmënaj



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA Vlorë
Këshilli i Bashkisë

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 12/1, datë 21.10.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëdita!

Meqenëse, kuorumi është realizuar, fillojmë mbledhjen . Është mbledhje jashtë radhe, nisur nga një kërkesë e datës 15 Tetor , nga 17 këshilltarë, për mbledhje të jashtëzakonshme...Sipas ligjeve..Ligjit 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, brenda afatit 5 ditor thirra këshillin e bashkisë për mbledhje me këtë rend dite:

-Shkaqet

-Masat e marra dhe, Transparenca .

Z.Endri Hyseni – Dua të bëj të ditur se, kjo mbledhje bëhet bazuar në kërkesën e 17 këshilltarëve, që nuk janë të gjithë prezent..Kjo në aspektin moral.

Z.Atird Hoxha – Të gjithë anëtarët e këshillit që bënë kërkesë për mbledhjen jashtë radhe...Në momentin që, këshilltarët kanë përcaktuar ligjin dhe nenin, kjo mbledhje, ky këshill do ishte mbledhur brenda 24 orësh. E gjej pa vend ndërhyrjen e zotit Hyseni. Kjo mbledhje është kërkuar nga ne , brenda 24 orëve..

Z.Ermal Dredha – Faleminderit për pjesëmarrjen dhe interesimin nga grupi i 17 këshilltarëve, për emergjencën, por ajo nuk ishte më në kohën që e kërkuat ju. Pra, emergjenca, mund të ishte 1 ose 2 ditë dhe, për të kontribuar të gjithë. Jemi gjithë kohën në terren, 24 orë në terren, me ato mundësi që kemi. E mira do ishte që kjo mbledhje të kishte një projektakt konkret . Por kjo nuk është sim und ti përgjigjesh komunitetit. Në datën 4 , edhe pse sinoptikanët, nuk e kishin planifikuar për Vlorën, por në Veri, por ja që ndodhi. Por ky problem nuk është vetëm në qytetin tonë, por dhe në shumë qytete dhe shtete. Po të kishit dalë në një projektvendim apo projekt propozim , megjithatë jam këtu për t’ju përgjigjur, jemi këtu për komunitetin. S’jemi këtu për të bërë retorikë. Ka ndodhur në datën 4. Nuk ka pas asgjë për tu fshehur nga Bashkia Vlorë. Nuk ka pas asgjë për të fshehur nga Bashkia Vlorë. Kemi qenë në aksin, në terren. Me 180ml/sek, Vlorë nuk do përmytej..ishite intensitet i madh i shirave. Është dhe pozicioni i qytetit, jo këtu, për tu shmangur nga përgjegjësia.

Nuk merremi dot me natyrën, por reagojmë. Gjithë mjetet kanë qenë në terren.

Është ngritur grup pune, për të shkuar derë më derë tek banorët. Ka qenë orientim i qartë për të gjithë. Kjo është e vërteta. Ka pas dhe një angazhim dhe nga institucinet dhe vullnetarë si Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Emergjencave dhe disa nga bashkitë e tjera. Ka pas mjete pa fund nga shumë qytete, Tirana, Durrësi, Fieri, Alb-Petrol etj. Analiza të tjera mund ti bëj, por do isha shumë i lumtur nëqoftëse do të kisha një propozim konkret. Për punën e bër vlen të përgëzoj Drejtorinë e Emergjencave. Është një fond i Emergjencave Civile, fond I pakushtëzuar, por që nuk përballohet dot. Por deri në momentin e fundit, derisa të plotësohen të gjitha të dhënat nga qytetartët, fondi ..Kemi përpiluar listat e familjeve me problemet he do të përzgjidhen ato më të vështira. KUL që është ndërtuar, ky kapacitet është shumë I ulët në lidhje me rreshjet e rëna. Për vetë faktin që nuk pash asnjë ndihmë nga asnjë nga ata këshilltarë që kanë firmosur. Mua më duket absurditet I madh. Gjithë pjesa e familjeve, Janë 365 familje, derë më derë kemi nxjerrë shifrat., dhe bizneset kanë patur dëmtime. Është Drejtoria e Rajonale e Tatim Taksave që po shkon në çdo biznes.

Ndërmarrja e Ujësjellës – Kanalizime ; 3bote; 1 skrep; 1 vinxh;

-5 gjeneratorë, forca punëtore dhe shërbimesh, NSHP.

-Drejtoria e Zjarrëfikëses – 3makina zjarrfikëse, punonjës;

-Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

-Bashkitë e tjera, megjithatë , ndihem I gatshëm të përqafoj ndonjë propozimin tuaj.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Falënderoj të gjithë anëtarët e Këshillit të Bashkisë,të PS, që pas thirrjes time, dolët të gjithë në terren.

Z.Myzafer Elezi – E kërkuam këtë mbledhje të jashtëzakonshme, pak me vonesë, t’ju linim të bënit punën. Zoti Kryetar, donim të na sqaronit në lidhje me problematikat,dëmet në qytetin e Vlorës.

Zoti Kryetar, e kërkuam këtë mbledhje të jashtëzakonshme për të informuar qytetarët, shkaqet përse u shkaktua kjo gjendje, informacion për fondet.

Z.Ermal Dredha – Jam I gatshëm për çdo lloj thirrje që bëni ju. E kam fjalën për mënyrën si e kërkon mbledhjen emergjente. Është mbledhje jashtë radhe. Nuk mund të palnifikoj dhe gjykoj dot për rënien e rreshjeve , duhet të reagojmë në kohë, shiun nuk e ndalojmë dot. Ishte 180ml shi..Jashtë tavolinave të politikave , kishte shumë që thoshin që nuk mund të ndalohej.

Z.Gjergji Nika – nuk e vë në dyshim që ju keni qenë në terren. Ishit në terren ju dhe zonja zëvendëskryetare. Neve jemi mbledhur... përse I përket sygjerimeve tuaja.Drejtoria e Emergjencave ka nxjerrë kostot, bëni analizë.Ne jemi këtu sot, pse jemi në këtë gjendje ? Pse nuk punoi hidrovari. Kemi ardhur që të shohim apo të dimë, kush është përgjegjësi.

Z.Ermal Dredha – Ka një problem. Kush mur , kush kanal u ça? Nuk është çështja.. Është amortizuar kanali , po. Ka qenë për 60ml/sek . Po flasim për 180ml/sek, shumë rreshje dhe kohë më e gjatë. Kanali nuk është çarë, është amortizuar. Kanë ndërtuar dhe legalizuar pa kriter. Kush ka përgjegjësi, le ta mbajë. Unë di të them, si reaguam ne si bashki. Një mur tek me beton ka rënë, kjo për informacion.

Z.Atird Hoxha – E shoh që ju doni ta mbani këtë përgjegjësi, por ka dhe institucione të tjera. Janë ligji “Për Emergjencat Civile” dhe “Për Vetqeverisjen Vendore“, ju keni detyrë të nxirrni njoftime..Ky propozimi ynë nuk është në hava.

Duam të dimë shkaqet dhe përgjegjësitë përkatëse. Juve si administratë.

Pika 2, kush janë masat e ndërmarra, për minimizimin e situatës. Çfarë masash kanë marrë NSHP, si dhe -Transparenca e fondeve.

Kanali ka 3 vjet pa pastruar, është informacion nga ana juaj.

Kjo ndodhi dhe kur u dogjën plehrat, falenderuat për rata që ndihmuan.

Opozita ka vetëm fjalën. Meqenëse janë të dy drejtuesit e Ujësjetës – Kanalizime dhe NSHP...Pra, ku janë gjithë punonjësit që kalojmë në në buxhet.

-Kush e ka në inventar kanalizimin .

Plani I punës, mjetet, procesi teknologjik

-A është parashikuar fondi ?

-Kanali I Nanunkës, kur është pastruar?

-KUSipërm me ekspertët,

Ne kemi sygjerime ..

-KUSipërm, kur është pastruar për herë të fundit ?

-Kanali që ndan “Bishtin e Kalldrëmit”..

-Kanali tek kryqëzimi , tek Drejtoria e Policisë

-Kanali tek “Fusha e Aviacionit”..Kur janë pastruar për herë të fundit.

Është dhe një Këshill Administrimi. Ne kemi dy përfaqësues në këtë këshill. Nuk dimë çfarë bëhet.

-Problemi I pompave të hidrovorit , u dogjën, nuk punuan.

Po për energjinë elektrike, di që nuk ka punuar gjeneratori, që u mbyt tek kisha.

Çfarë masash paraprake keni marrë për parandalimin e gjendjes. Në kuadër të problematikave në qytet.

Këtë mbledhje që po bëjmë sot, pse nuk e bëmë më shpejt.

Kam dhe disa shqetësime . Linjat e reja në çdo rrugë kemi përgje me zhavor.

Çfarë lloj leje kanë këta. Ky është dhe një shkak për përmbytjen në qytet. Kur do kthehen në gjendjen e mëparshme këto rrugë ?

Të shqyhet qyteti në këtë mënyrë dhe nuk dijnë qytetarët kur fillojnë dhe kur mbarojnë këto punime

-Stacioni pompimit. Shkaku kryesor për përmbytjen tek kisha “Ortodokse” Ka ndodhur përmbytje, por nuk kanë zgjedh.

Z.Ermal Dredha – Nuk erdhët me propozim konkret.

Z.Atird Hoxha – Duhet të vini ju me propozime konkrete. Sa fond duhet .. Të gjitha dëmet që janë evidentuar , I sillni, numrin e familjeve, dëmet.

Z.Ermal Dredha – 365 familje . Dëmi total , nga Drejtoria e Emergjencave Civile 58mln701.448, afërsisht 600 milion. Dëmeve të tjera dhe bizneseve , I përmenda më sipër, I ka Drejtoria

Rajonale e Tatimeve. Po I flas sipas rajoneve ..Që ditën e parë, ne kemi ngritur një grup , nuk është se ka qenë një problem madhor, por e kam tek pjesa e dimensionimit.

Pjesa e pompimit, nuk ka punuar . Uji shkoi e mbushi dhe nuk punoi. Nuk ka qenë uji present 48 orë , por 24 orë. Uji u tërhoq. Kemi dalë bllok më bllok. Kjo nuk bëhet brenda ditës.

-NSHP është në terren, në larjen e rrugëve.

-Kanali I Nanukës, është pastruar. Me ato lloj rreshjes , është e pamundur , por dhe amortizimi I kanaleve.

A mund ta kishim minimizuar? – Po, mund ta kishim bërë, por me këto lloj prurjesh ..

Ka instanca përkatëse që merret me ato, ku çedon problemi. Po, ju si këshilltarë, keni ardhur me një propozim konkret ? Pse duhet të mblidhemi vetëm kur bie shi apo bie zjarr, të mblidhemi ne.

Z.Atird Hoxha – Kam bërë gjithë këto pyetje. Përderisa drejtuesit janë këtu , të na kthejnë përgjigje. Kanë 3 vjet kanalet pa pastruar.

Z.Grigor Dede – Ishte gjendje e jashtëzakonshme , të gjithë u prekëm. Që ta zgjidhnim, vendosëm njerëz në punë , për të zgjidhur..Kemi qenë në terren, jemi interesuar, kemi kontaktuar me qytetarë, me punonjës të emergjencave civile. Dua të përmend , pjesën e kurajës së Kryetarit të Bashkisë dhe po mban përgjegjësi dhe diskuton me këshillin pas 15 ditëve. Nuk I pamë këta këshilltarë të opozitës të ishin në terren. Sa herë që ndodh një ngjarje, që të bëni ato reagime, shoë I radhës . Nuk është kjo që kujtoheni pas tre javësh. Njoftimi sipas ligjit, duhet 5 ditëshi. Neve ishim në terren, juve nuk ju pamë.

Znj.Anxhela Shenaj – Kam disa pyetje.

-A ka dokumenta planifikuese menaxhimi

-Në dëgjesën publike një qytetar ka bërë ankesë për KUL, kur është pastruar për herë të fundit.

-Është vlerësuar masa e dëmeve tek banesat dhe bizneset?

Ky fakt tregon se, është mos menaxhim nga institucionet.

-Kush do të mbajë përgjegjësi

-Çfarë do të bëhet me këto institucione që mbledhin taksat e qytetarëve(publikon foto)

Kërkoj të vihen përgjegjësit para përgjegjesisë. (Bashkëlidhur diskutimi)

Z.Ermal Dredha – 67 garazhe u përmbytën. Për pastrimin është bërë punë kolosale. Ka qenë kaos..Është dhjetëfishuar puna..Në ditët e para ishte gjendja e pamenaxhuar.

Z.Novrus Rrokaj - Duke qenë I mirëkuptuar me mbledhjen e këshillit për mbledhje të jashtëzakonshme..Përfitoj nga rasti që janë për tu përgëzuar stafi I bashkisë për punën kolosale që ka bërë. Kanalizimet e Vlorës, janë të para vitit 1990. Këtu për mendimin tim, të bëhet një plan dhe mëe strukturat qeveritare që kjo situatë most ë përsëritet . Tek “Albano& Romina” duhet ndërhyrë në tubacion me Ó...

Nëqoftëse do bëhet shkarkimi në lidhje me Firmën “Kamataqis”..., ka nevojë për ndërhyrje dhe për të bërë një plan që kjo situatë most ë përsëritet. Ka përgjegjësi dhe institucioni ,edhe qytetare. Unë shpresoj dhe mendoj që bashkia do ndërhyjë.

Z.Geron Gunbardhi – Dua t’ju falenderoj për punën e bërë me stafin, guximin që merrni përsipër ,përgjegjësi të paraardhësit. Ju ishit në terren.

Mendoj që e diskutuam , që duke qenë në terren, të mblidheshim për mbledhje..

Ne kemi bërë një dosje gati , do merren organet kompetente. Jo vetëm faji I rreshjeve të fundit. Fondi për pastrimin e kanaleve..Procesverbalet e pastrimit të kanaleve janë në dosje të KLSH. Po flas në emër të biznesit. Ka pas shira dhe përmytje. KUL ka pas një liqen , ujrat e para të vinin në liqen, pastaj në kanal, në vitin 2017..Bëj dhe një deklaratë për dorëheqje ..

Liqeni me fondet e shtetit zviceran.

Kam foto dhe video në kanale , pra nuk është pastruar, ka kohë.

Me fillimin e shirave, punonjësit, nuk ishin në krye të punës. S'është e nevojshme të falenderohen. Pyetjet janë, jo çfarë bëtë...

-Tek 4 topat , nuk është mbytur ndonjëherë. Është një kanal 2,40 x1,40..kjo tubo është zëvendësuar..

Të gjitha këto, nëqoftëse, do të ishin bërë më parë, nuk do të ishte kjo gjendje. Nëqoftëse doni propozimin tonë, lexoni materialin e KLSH, bëni kallzime.

Z.Ermal Dredha – Nuk heq asnjë presje për çfarë thatë. Shqetësimi është për të gjithë ne, për qytetarët...Marja përgjegjësi...ata I bëjnë të gjitha , KLSH Me njerëzit që punoj , përgjegjësia del vetë. Për çdo funksion ka detyra, bëhet një plan pune. S'janë pastruar kanalet ,thoni ju ? Janë pastruar. Kanali iDo të doja të ishte ndonjë drejtor Naunkës; shinat e trenit ; Paraburgimi ; Hidrovori; KUB në lagjen “Lirim”

Znj.Edlira Kapllanaj – Jemi mbledhur sot për të diskutuar një çështje shumë të rëndësishme. Së pari,

-Solidariteti, është fuqia jonë më e madhe. Të qëndrojmë pranë njëri tjetrit .

-OJF në bashkëpunim për shpërndarje ndihmash.

-Strehimi është emergjent.

-Mbështetja psikologjike

Duhet të mendojmë për të marrë masa për parandalimin e situatave të tilla. Duhet bërë një plan dhe me qeverinë.

Nuk lë pa përmendur punën e Kryetarit të Bashkisë dhe të Kryetarëve të rajoneve. Falenderoj mobilizimin e çdo këshilltari që ishte në terren.

Z.Klodian Xhyheri – Do të doja të ishte ndonjë drejtor këtu, jo të gjitha përgjegjësitë ju zoti Kryetar.

Pse u mbyt Vlora.

-Rrjeti I kanalizimeve, I ujrave të bardha e të zeza, nuk ishin pastruar dhe as investuar në to.

-Hidrovori jashtë funksionit.

- Nga 4 pompa, 3 jashtë funksionit.

Unë mendoj që pasojat nuk do të ishin kaq të mëdha, nëqoftëse, nuk do ishte punuar dhe investuar.

-Projekti I Ujësjellësit, problem, të gjitha rrugët të hapura, edhe ai ka shkakun e vet.

Për dëmshpërblimet, do jepen ca, pastaj do harrohet.

Çfarë duhet të bënim zoti Kryetar. Të dilnim nëpër lagje , të shpërndanim pako?

Duhet të mblidheshim ?

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Ja ku u mblodhëm dhe pse shumë nga opozita menduam se nuk do mblidheshim.

Z.Klodian Xhyheri – Duhet të investojnë.

Z.Ermal Dredha – Pakot është detyrim, një gjest human. Mjeti I informimit është rrjeti social. E kemi sim jet informimi dhe burimi për qytetarët. Sa I përket pjesës së kanalizimeve, për punimet. Projekti është 18 muaj. Gjatë verës ka fluks dhe s'mund të punohet, prandaj u ndërprejnë punimet dhe rimorën në shtator. Kemi kërkaur që akset kryesorë të mbyllen para sezonit turistik. Janë dy projekte të ndryshme, ky është me KFW. Do bëhet testimi.

Z.Gjergji Nika – Përmbytje, normalisht ka. Mos bëra e detyrës ka sjellë gjithë këto dëme. Drejtorit të Ujësjetës, disa pyetje.

Përgjigjet me shkrim.

-Grykat , qemerët pa pastruar,

-Kanali I Siavit

-Knali tek Spitali Psikiatrik

-Kanali tek Shkolla Tregëtare

-Kanali tek stacioni I Karafilit, janë pa pastruar..Duheshin hapur qemerët

-Kanali tek Paraburgimi, të gjitha këto pa pastruar. I dua këto, para 4 Tetorit, pra viti 2023, viti 2024. Asgjë nuk është pastruar. As pjesa e zgarave nuk është hapur dhe pastruar. (Bashkëlidhur diskutimi)

Z.Sokol Kananaj – Të shikojmë, objekti I shoqërisë

-Stacioni..Në lidhje me të gjitha veprimet çfarë kemi bërë. Kemi dispeçeri..Në lidhje me analizën e shirave, çfarë procedure. Si është ndjekur e gjithë procedura, ju'a sjellim.

Z.Atird Hoxha – Informacioni, relacioni që ka zoti Sokol...Meqenëse kemi bërë pyetje konkrete , le të përgjigjet.

Z.Sokol Kananaj – Inventarin, nuk e dimë si procedurë. Pra, kush e ka. Këto kërkesa , në rastet konkrete, sin ë rastin e ujit të ndotur , nuk kanë dalë lart asnjëherë, janë bërë analizat.

Ju thoni, kanalet nuk janë pastruar. Do t'ju a sjell informacionin . Mos I ngatërroni, kanalet me përdua.

Z.Myzafer Elezi – Kërkoj me shkrim;

A keni ndonjë plan për pastrimin e kanaleve ?

A është protokolluar dhe kush e ka miratuar ?

Mund të na sillni një kopje ..Kërkojmë një relacion si është zbatuar ky plan.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Në një shkresë që I është dërguar bashkisë nga këshilli I bashkisë, administrate do kthejë përgjigje për të gjitha pyetjet dhe kërkesat për datën 28 Tetor.

Z.Ermal Dredha – Ndonjë propozim ? Jemi në komunikim të drejtpërdrejtë me qeverinë. Të jemi gjithëpërfshirës.

Znj.Liljana Breshani – Janë fatkeqësi natyrore. Të gjithë bëhemi bashkë në të tilla raste. Nuk kam parë asnjë nga jut ë vinte të ndihmonte qytetarët, të pastronte. Nuk pashë askënd nga ju , që

të vinte të shprehte vullnetarizmin, humanizmin. Nuk dini fare, çkemi bërë ne me kryetarin. Do ti bëja thirrje gjithë qytetarëve, që në çdo kohë të jemi për të mbajtur pastër ambientin dhe qytetin tonë.

Znj.Rajmonda Zoto – Në përgjigje të këshilltares Breshani, të gjithë këshilltarët kanë qenë në terren. Por, situata që u krijua, nuk mund të rrije pa angazhuar për përballimin e situatës .

Fatmirësisht , Qendra shëndetësore u shpëtua falë angazhimit të punonjësve por dhe të qytetarëve. Të gjithë jemi këshilltarë, por jemi qytetarë. Unë them ti lëmë këto , jemi qytetarë. Edhe në disa zona që kemi shkuar , ka pas problematika të mbartura. Përse të mos u paraprijmë këtyre problemeve. Mendoj që, jemi të gjithë fajtorë. Të ketë bashkia një plan për të përballuar situatë të tilla. Nuk jemi ekspertë , port ë jemi bashkë me ekspertët për të përballuar situatë të tilla.

Z.Erëmal Arapi – Ne në këtë mbledhje nuk marrim asnjë përgjigje. Një masë parandaluese. Kjo administratë, këto institucione , a marrin masa për parandalim ..Mendoj se, drejtuesit e ndërmarrjeve , duhet të ishin të përgatitur për pastrimin e kanaleve. Është hera e parë që kemi përmytje në lagjet e lartme. 600 milion lekë dëm. Mendoj që, është më shumë. Janë përmytur lagjet e lartme si, Karabashi, Topana . A kanë qenë në monitorim këto kanale ? Qytetarët kanë qenë duke nxjerrë ujin për 3-4 ditë.

Z.Ermal Dredha – Drejtuesit e ndërmarrjeve duhet të ... Nuk ka lidhje ... Vetëm të tregonit një farë sensibilizimi, që të jemi të gjithë bashkë. S'kemi kujt ti drejtojmë gishtin, një personi. Mos ta politizojmë. Janë dhe shkaqe natyrore. Mund të ketë problematika të mbartura, ka shumë hallka. Puna është, si ti parandalojmë.., por kjo , na hap ne sytë për të përballuar këto situatë. Të gjitha pyetjeve do tu kthehet përgjigje ...kuntat janë bërë para shiut, por si janë bërë, nuk jam ekspert.

Këtu është ndërtuar në mënyrë abusive, mbi kanal, në anë të kanalit. Idea është që, ne të marrim një vendim.Ne do të ngremë një grup pune me IMT,Urbanistikën etj ..Idea është që, të dalim në një propozim konkret. Prishjet do vazhdojnë, shumica janë legalizuar, do bashkëpunojmë me Hipotekën..Të shohim, ku realisht çënohet qyteti.

Z.Atird Hoxha – Drejtuesit e institucioneve..Unë mendoj që, detyra e këshillit ...Drejtuesit duhet ta kishin një përgjigje në lidhje me kërkesat e bëra, plus ndërkohë ato pyetje që duan kohë për me shkrim.

Z.Ermal Dredha – Në çdo mbledhje të këshillit të bashkisë, të gjithë drejtorët I keni në sallë.

Z.Atird Hoxha – Për ekto kërkesa, do marrim përgjigje me shkrim.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Në mbledhjen e radhës, drejtori do ketë një raport për të gjitha pyetjet.

Znj.Elca Bezhani -Situata ka qenë problematike dhe e ndjeshme për të gjithë. Bashkohem me zonzjën Zoto , nuk do shumë punë që të bashkohemi në situata të tilla. Kam qenë në kontakt me punonjësit e terrenit. Ka një plan Emergjencia Civile. Plani I tyre , si fillim është parandalimi si dhe organizimi I strukturave. Duhet bashkëpunim me inxhinierët e fushës . Është një iniciativë për tu përshëndetur në lidhje me këta ekspertë që e njohin gjendjen. Familjet kanë pas dëme në orendi shtëpiake, etj. Di që punonjës të mergjencave civile, kanë shkuar në banesa.

Është një fond rreth 60 milion lekë. Nuk e kemi kulturën e sigurimit të banesës. Megjithatë në buxhetin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2024, që llogaritet 4% nga emergjencat civile, rreth 50 milion lekë ..Nga qeveria është akorduar një fond për emergjencat civile prej... lekë/reja. Deri tani nuk janë llogaritur të gjitha dëmet . Them që fondi nuk mjafton. I them administratës së bashkisë të bëjë kalkulimet e duhura . Edhe nëpërmjet Drejtorisë së Emergjencave Civile ,mund ti kërkohet fond qeverisë, për përballimin e situatës. Administrata të vijë me një projektvendim. Z.Endri Hyseni – Për procedurë. Të gjithë diskutuan , por nuk ka pas një projektakt konkret. Znj.Eda Begaj – Gjatë diskutimeve, Ju zoti Kryetar, përmendët që nuk jeni këtu për të tërhequr vëmendje. Është e vërtetë. Jemi në situatë të vështirë zoti Kryetar. Punët e mira duken nga faktet. Propozim, që nga sensibilizimi I qytetarëve ..u pastrua..Duhet të kemi politika më të forta, sidomos në sezonin turistik.

Hidrovari, ka nevojë për restaurim.

Shtimi I koshave të mbeturinave

Mbyllja e të gjitha segmenteve të hapura. Pas mbylljes mos të ketë, mos të lejohet të ndërtohet mbi to.

Z.Ermal Dredha – Hidrovari..Nga e morrët këtë informacion , që s'ka punuar? Hidrovari I bashkisë ka punuar, të dy hidrovorët, por ai I ujrave të zeza ka ndaluar për disa momente. Kjo ka qenë pak a shumë problematike. Këto janë çështje teknike.

Për pjesën e investimit për ujin e pijshëm, janë me radhë, me protokoll punimesh. Deri në prill ..kanë dhënë ...

Z.Geron Gunbardhi – Mbledhja, me kërkesat që ne bëjmë.., pyetjet që ne kishim bërë me shkrim.., propozoj të vëmë një pagë minimale për familjet në nevojë, të japim të gjithë një kontribut.

Kemi 5 rajone. Mendoj që është detyra e tyre ligjore...Kërkesa jonë është bërë deri në datën 4 Tetor, jo pas datës 4 Tetor..Pra, rajonet të sjellin informacion për situatën. Këtu thuhet shumë gjëra dhe nuk bëhen. Për ndërtimet e bëra, le të bëhet kallzim penal..E ka ligji.

Z.Ervis Moçka – Jam dakort me zotin Gunbardhi. Po prisja një propozim të jashtëzakonshëm për këtë mbledhje. U bë mbledhje jashtë radhe...Është shumë mirë kjo mbledhje... Edhe pas 3 orësh nuk erdhi ndonjë prpozim. Sikurse tha dhe zonja Bezhani , fondi rreth 60 milion dhe fonde të tjera, të gjenden dhe të mblidhen për tu ardhur në ndihmë qytetarëve. Të shtohet fondi I emergjencave. Një prpozim I drejtë nga zonja Bezhani për fonde nga Drejtoria e Financës dhe një rrogë shtesë atyre punonjësve që punuan.

Znj.Elpiniki Mërkuri – Propozimet e bëra janë mëse të sakta .

Falenderojmë punonjësit e Ujësjellës -Kanalizime, NSHP-së dhe urojmë të kthehet Vlora sa më shpejt si më parë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 13, datë 28.10.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria” ; Mbledhja e radhës (Ora 10:15)

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1.Liljana Breshani | 20.Vjola Xhafaj |
| 2.Geron Gunbardhi | 21.Simbol Pazaj |
| 3.Vullnet Bilbilaj | 22.Gjergji Nika |
| 4.Roland Strakosha | 23.Frosina Qyrdeti |
| 5.Illir Aliaj | 24.Refie Laze |
| 6.Endri Hyseni | 25.Atird Hoxha |
| 7.Sokol Kushta | 26.Elca Bezhani |
| 8.Lorel Canaj | 27.Erëmal Arapi |
| 9.Novrus Rrokaj | 28.Klodian Xhyheri |
| 10.Grigor Dede | 29.Brikena Puka |
| 11.Brikena Sika | 30.Arsen Belaj |
| 12.Rajmonda Zoto | 31.Eglantina Aliaj |
| 13.Mujo Shakaj | 32.Ledja Shollaj |
| 14.Elpiniqi Mërkuri | 33.Edison Kapaj |
| 15.Besmir Brahimi | 34.Edlira Kapllanaj |
| 16.Myzafer Elezi | 35.Bujar Osmënaj |
| 17.Simo Petromilo | 36.Shkëlqim Leskaj |
| 18.Briseida Çakërri | 37.Evis Allushi |
| 19.Ervis Moçka | |

Mungojnë:

- 1.Ardian Musta
- 2.Anisa Ceno
- 3.Gëzim Çapoj
- 4.Jerina Dervishaj
- 5.Aurora Qarri
- 6.Marsela Dashi
- 7.Eneida Vera
- 8.Alta Haluci
- 9.Anxhela Shenaj
- 10.Liri Dëma
- 11.Dikens Bushaj
- 12.Englantina Imeraj
- 13.Eda Begaj
- 14.Arjan Isufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 13/1, datë 28.10.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes! Meqenëse kuorumi është plotësuar, fillojmë mbledhjen. Vazhdojmë me shprehjen e ligjshmërisë për VKB Nr 84-87, datë 26.09.2024, janë vendime me karakter individual dhe të ligjshëm nga Institucioni I Prefektit të Qarkut Vlorë.

Kalojmë në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 26.09.2024. Votohet.

Miratohet.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Keni gjë në lidhje me rendin e ditës ?

Z.Gjergji Nika – Në mbledhjen e kaluar lamë detyrë SH.A.Ujësjesit të na sillte informacion përsa I përket , pyetjeve në mbledhjen e kaluar. Ky informacion nuk ka ardhur. Mosprurja e informacionit tregon arrogancë.

-Kemi projektvendimin për monitorimin, kemi 2 drejtori. Mund të kemi dhe pyetje të tjera. Është analizë 8-mujore , kështu që thërrisni dhe drejtoritë e tjera .

Znj.Irena Toshkallari – Janë të pranishëm drejtorë dhe drejtorë të përgjithshëm për tu përgjigjur , për drejtoritë që mbulojnë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Në lidhje me pikën 1 zoti Nika, mora kontakt me drejtorin e ujësjesit, dhe më tha, brenda ditës së mërkurë , do të keni informacionin, përgjigjen e pyetjeve.

Z.Geron Gunbardhi – Zonja Kryetare. E marrët përsipër që në datën 28 , do të vinte përgjigje.

Z.Daut Zëraj – Për procedurë. Të mbarojë me shprehjen e ligjshmërisë , ishin dy shkresa.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Edhe mbledhjen e kaluar , unë s’jam për betimin e drejtorit.

Shkresa ka shkuar ditën e premte dhe, përgjigjia do vijë deri të mërkurën.

Z.Myzafer Elezi – S’është vetëm fakti që shkresa shkoi ditën e premte. Drejtori ishte prezent, prandaj është e pajustificuar.

Z.Atird Hoxha – Përsa ju përket përgjigjeve që duhet të jepet Sh.A.Ujësjesit në lidhje me kërkesën me shkrim. Jeni në shkëlqje të rregullores. Edhe në bazë të rregullores, pikat e patrajtuara, mbledhjen e ardhshme , do diskutohen pikë e parë e rendit të ditës. Në shkresë ishin 3 pika.

Ishin prezentë ,dhe drejtori I Ujësjetllësit. Nuk kanë përgjigjen, jo nuk ka shkuar shkresa. Kërkesat me pyetjet tona i kemi depozituar në Sekretariat. Është kërkesë mëse e drejtë për informacionin që kërkojmë , në lidhje me situatën që u krijua.

Pra, të majtë dhe të djathtë. Ne po kërkojmë informacionin që e kërkojnë shumë qytetarë. Nuk është hera e parë. Ju si Kryetare, vendosni autoritetin tuaj dhe dinjitetin e këshilltarëve , të majtë e të djathtë.

Znj.Elca Bezhani – Në lidhje me kërkesat e bëra, s’ka justifikim. Nuk qëndron përgjigjia e Drejtorit të Sh.A.Ujësjetllësit, që ka marrë me vonesë shkresën. Është situatë emergjente. Të kishte punuar dhe ditë të shtunë e të dielë. Është situatë emergjente. Të vinte sot të raportonte. Nuk ka justifikim.

Z.Erëmal Arapi – Falënderoj zonjën Bezhani për këtë diskutim. Zonja Kryetare, I dini kompetencat tuaja, e dini pozicionin tuaj dhe të këshilltarëve, jo që, s’keni çfarë të bëni.

Z.Ervis Moçka – E dëgjuat, përgjigjen e zonjës Bezhani. ..jo zyrtare nga kryetarja ...

-Çfarë propozoni për ta rregulluar këtë situatë.

Z.Gjergji Nika - Ujësjetllësi po vepron si në Qershor me pagat . E anashkaloi. Sot drejtori s’është. Të lajmërohen të dy anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, të jenë më vonë në mbledhje. Drejtori I Ujësjetllësit, përgjigjet para Këshillit Mbikqyrës. Të njoftohen dhe të vijnë në mbledhje në fund të rendit të ditës. Po diskutojmë që, Ndërmarrja e Ujësjetllës – Kanalizime, ka mbytur Vlorën , nga mospastrimi I kanaleve. Duhet ta çojmë deri në fund.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Ndonjë koment ?

Z.Klodian Xhyheri – Propozoj të bëjmë një mbledhje, një interperlancë me vete. Të lëmë një seancë të veçantë , të na japin materialin përkatës Pastaj në atë seancë, e analizojmë në thelb problemin.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Ndonjë propozim ?

Z.Geron Gunbardhi – 17 këshilltarë bënë kërkesë, për problematikën , për situatën e krijuar. Çfarë është bërë deri në datën 4..Gjithë kërkesat që bëme..Do ta pranojmë gjithë këtë arrogancë ? E pranojnë këshilltarët e majtë këtë fyerje apo jo ?

Z.Erëmal Arapi – E keni të sigurt që e keni çuar shkresën ditën e premtë ?

Z.Atird Hoxha – Ishte I pranishëm vetë drejtori këtu.

Z.Ervis Moçka – Filluan diskutimet.U mbyt Vlora...Për të diskutuar , për procedurë, këshilli është institucion, s’ka të majtë e të djathtë. S’është nevoja sot ta diskutojmë në thelb. Zoti Klodian ta bëjë propozimin, ta hartojë. Bazuar në Neni 78, ka kërkuar interperlancë . Këshilli është institucion, ka të drejtë ligjore ta thërrasë , të vazhdojë procedurën. Fyhet institucioni, jo këshilltarët.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Jemi të qartë në lidhje me këto.

Vazhdojmë me shkresën e dytë të shprehjes së ligjshmërisë , për VKB Nr 88 – 91, datë 26.09.2024, të cilët vlerësohen të ligjshëm nga Institucioni I Prefektit të Qarkut Vlorë.

Faleminderit.

Për rendin e ditës , keni diçka ?

Votohet.

Pro –

Z.Gjergji Nika – Dhe herën e kaluar në Qershor, kështu u anashkalua. Kështu do bëhet përsëri.

Z.Ervis Moçka – E lamë për interpelancën, nga propozimi I bërë. Nuk e miratoni, pse nuk erdhi përgjigjia..Po do lëmë pa votuar ndihmën ekonomike ?

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Ta kalojmë në votë rendin e ditës?

Mos ta lëmë ndihmën ekonomike.

Z.Novrus Rrokaj – Propozimin tuaj , ne e kaluam, do të bëhet, thirret në interpelancë.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Ndihma ekonomike ka afat ligjor, nuk mund ta vonojmë.

Z.Ervis Moçka – Për procedurë. U miratua rendi I ditës. Nuk e kuptoj.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – E kuptoj shqetësimin tuaj në lidhje me Ujësjellësin. E diskutuam. Ne si këshill bashkiak I kemi diskutuar dhe dërguar shkresën. Në lidhje me propozimin tuaj , e vendpsëm. Do ta çojmë kërkesën për interpelancë, por për ndihmën ekonomike, po ridiskutojmë shumë.

Znj.Elca Bezhani – Zoti Xhyheri kërkon që të bëhet një mbledhje jashtë radhe . Nga drejtori I Ujësjellësit të bëhet materiali. Materiali që do sjellë drejtori I Ujësjellësit, unë dua ta lexoj. Është mirë të vazhdojmë me rendin e ditës. Kam gjëra për të thënë përgjatë mbledhjes. Ti kërkojmë llogari administratës .

Z.Atird Hoxha – Marr shkas nga diskutimi I zonjës Bezhani ..Edhe ne jemi të përgatitur. Përsa I përket pikës që diskutuam, këshilltarët opozitarë, jashtë kamerave , ndajnë të njëjtin shqetësim me ju. Në mbledhjen e jashtëzakonshme, që ju e quajtet jashtë radhe, drejtuesit nuk I kanë këto pozicione për të ...Këshilli është mbi gjithçka , ka atributet e veta. Pse duhet të japim konsensus për drejtorët

Ju kërkojmë që kjo mbledhje të vazhdojë, pavarësisht se një ose 2 drejtorë, s'duan ti'a dijnë për ne .

Ne kemi dhënë një herë consensus. E kishim kërkesën me 3 pika. Duhet të sihin të përgatitur në mbledhjen e jashtëzakonshme, apo jashtë radhe. Këta punonjës duhet ta kuptojnë , që s'janë mbi këshillin.

Znj.Rajmonda Zoto – Kemi pas kohë mjaftueshëm për tu njohur me rendin e ditës. Duhet të votojmë rendin e ditës. Në Konferencën e Kryetarëve, duhet ta kishit vendosur për marrjen e këtij informacioni. Unë jam dakort me këtë rend dite.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – 10 minuta pushim.

Largohen këshilltarët:

- 1.Gjergji Nika
- 2.Atird Hoxha
- 3.Klodian Xhyheri
- 4.Erëmal Arapi
- 5.Arsen Belaj

6. Refie Laze
7. Geron Gunbardhi
8. Myzafer Elezi
9. Besmir Brahimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 13/2, datë 28.10.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Rifillojmë mbledhjen.

Kalojmë në votim rendin e ditës.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Z.Ervis Moçka – Ndodhi një situatë.., U kërkua pushim nga ana Juaj.. Diskutuam. Ishin kërkesat në shërbim të qytetarëve dhe të këshillit .Zonja Bezhani e theksoi...U diskutua dhe kërkuan mbledhje tjetër në lidhje me inetrpelancën. Ramë dakort parimisht. Nuk e kuptoj pse nuk erdhën për vazhdimin e mbledhjes..

Përsa I përket procedurës . Në sallë ishin 32 këshilltarë. Nëqoftëse, do i kthehemi miratimit të rendit të ditës, Ligji 139/2015, për rendin e ditës nuk është shprehur, jo shumë të cilësuar. Në pushim vendosëm dhe dakortësuam për mbledhje jashtë radhe, për interpelancë, por nuk e kuptoj pse nuk e vazhduan rendin e ditës, sikur vetëm për ndihmën ekonomike.

Në sallë janë 27 anëtarë, u rimiratua rendi I ditës. Më vjen keq , shqetësimi I tyre , ishte ndoshta mosvazhdimi I mbledhjes, pasi për të gjitha u dakortësua.

Z.Grigor Dede – Isha prezent në diskutimin me opozitën. Nuk e kuptoj pse u larguan. Më vjen mirë që zonja Zoto tregon qytetari. Nuk e kuptoj pse opozita, nuk është prezent. Ne e pranuan propozimin e tyre për mbledhje jashtë radhe dhe interpelancë. Falënderoj zonjën Zoto që po qëndron për miratimin e projektvendimeve të ndihmës ekonomike dhe planin social.

Z.Illir Aliaj – Në lidhje me kërkesën e opozitës , meqenëse ata s’po qëndrojnë për miratimin e ndihmës ekonomike, propozoj që, kërkesa e tyre të jetë një pikë në rendin e ditës në mbledhjen tjetër, jo mbledhje tjetër.

-Përgëzohet Bashkinë Vlorë në lidhje me investimin e bërë në varrezat e qytetit.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Viojmë me pikën 1 të rendit të ditës, me projektvendimin “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin shtator 2024”.

Votohet

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Znj.Elpiniaq Mërkuri - Në zbardhje me propozimin e zotit Endri, për VKB 100, të shtohet termi “i ndryshuar” .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 13/3, datë 28.10.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin shtator 2024”.

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 13/4, datë 28.10.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e Planit Social Lokal, për vitet 2025-2027”.

Znj.Irena Stasa – Është plani i dytë social, në fillim me Qendrën multifunksionale. Bashkia Vlorë dhe Bashkia Korçë, janë bashki pilot ,... është drejt socializimit.Plani i ri social është 3 -vjeçar, kur përfundon i pari, aplikohet plani Social Lokal 2025 – 2027. Kemi punuar me tërë grupet e interesit , bazuar në ligje dhe legjislacionin në fuqi, etj.

Kemi nxjerrë dhe prioritetet, disa nga të cilat janë :

- Ngritja dhe fuqizimi i strukturës së ndihmës ekonomike, pra me një psikolog.
- Ngritja e një qendre ditore me PAK, deri në moshën 21 vjeç, por dhe një qendër ditore për moshën e tretë, ta kemi ne si bashki çdo ditë me një vakt.
- Ngritjen e një qendre shëndetësore.
- Për Qendrën PAK, të ulen tarifat , si dhe pjesëmarrja falas në ambjentet sportive, kinema. Prioritet dhe shërbimet në familje.

Znj.Edlira Ngjeci /Eksperte e Politikave Sociale – Plani social është për 3 vjet, detyrim i bashkisë për shërbimin social. Plani është një dokument shumë i rëndësishëm, për grupet në nevojë, grupet vunerabël dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky plan ndihmon në përfshirjen sociale. Nevojat janë të mëdha , por të dimë qartësisht drejtimet ku duhet të kalojmë. Ne jemi munduar të operojmë me institucionet dhe target grupe të shumta të interesit. Plani është ndarë në 2 pjesë:

1-Analizë e thelluar..Strukturat që përfshihen, grupet në nevojë.

2-Plani, vizioni ..Kemi të listuara të gjitha grupet në nevojë. Sigurisht, ky është një plan, por mund të ndryshojë , të abditohet.

Është bërë përveç analizës dhe cilat janë sfidat, vështirësitë (janë pasqyruar të gjitha vështirësitë)..Fushat e shërbimit social.

Plani ka një vizion. Është plan 3-vjeçar, por për të arritur atë vizion, duhet kohë.

Objektivat specifike, janë 2:

-Ngritja dhe funksionimi i strukturave të shërbimeve ..

Për secilën nga objektivat kemi ;

-Objektivi i parë , është parë rritja e stafeve sociale si në bashki dhe njësi administrative.

Sigurisht , një rëndësi e madhe i jepet dhe rritjes së kapaciteteve që përballen drejtpërdrejt këto grupe.

-Monitorimi ..Bashkia duhet të jetë e mirëinformuar. Të gjitha udhëzimet po i japin shumë rëndësi bashkive.

-Shërbime të reja .

Bashkia Vlorë është një bashki pilot, detyrim , jo vetëm për shkak të reformës, por Bashkia Vlorë , nuk ka më fëmijë në qendrën e fëmijëve.

-Ngritja e një Qendre me PAK, për mbi moshën 21 vjeç.

-Ngritja e një qendre të re për moshën e tretë. Por vëmendje i është kushtuar dhe për të rinjtë viktima të tariffikimit. Në projektvendim i kemi të detajuara. Është realizuar dhe dëgjese publike. Nëse keni diçka..

Znj.Rajmonda Zoto – Në Planin social, a është përfshirë dhe punësimi i këtyre personave ?

Znj.Edlira Ngjeci – Punëkërkues, si persona me AK?

Znj.Rajmonda Zoto – Këta persona nuk kanë shumë mundësi punësimi, nuk kanë akses. A duhet të futen në portale?

Znj.Edlira Ngjeci – Janë rekomanduar, janë pjesë e fokusit. Janë propozime dhe sa më konkrete si, dhe mes të tjerave, për ti ndihmuar ata.

Znj.Rajmonda Zoto – Personat me aftësi të kufizuar kanë nevojë për akses të tjera, nuk i mundësojnë dot vetë.

Znj.Edlira Ngjeci – Po propozojmë përtej moshës 21 vjeç. Është një proces, do mari kohë. Nuk janë lënë, janë parë si grupe prioritare.

Znj.Edlira Kapllanaj- Ky plan përfshin..(lexon) përfshin arsimin , ndërtimin e shkollave,...

-Këtu kemi shtuar dhe ngritjen e një çerdheje, pasi 3 janë në Bashkinë Vlorë.

-Të mëshojmë në fakt , për ndërtimin e banesave sociale.

-Në shërbimin publik.

Falenderoj Qendrën Psiko Sociale “Vatra”, për punën e bërë në lidhje me vajzat dhe gratë e dhunuara..

-Në lidhje me barnat, të tregohet kujdes, pasi moshës së tretë, nuk i del pensionipër ti blerë këto.

-Do të doja statistika në lidhje me barazinë gjinore., të punësuar në Bashkinë Vlorë.

I uroj suksese kësaj drejtorie në Bashkinë Vlorë.

Z.Endri Hyseni – Jemi njohur të gjithë me këtë plan social.Kemi qenë pjesë e dëgjësës publike.

Nga drejtoresha jemi njohur , për mungesën e stafit.

Propozoj që,në bushetin e vitit 2025, administrata të parishikojë dhe një staf akoma më të gjerë dhe, ta sjellë në këshill.

Znj.Brikena Puka – Janë vlerësuar nevojat , janë bërë takime me grupet e interesit. Vëmendje ka dhe nga Kryetari i bashkisë, përveç qendrave ekzistuese , por dhe atyre të reja. Staf i është i domosdoshëm për monitorimin e këtij shërbimi.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim?

Votohet.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 13/5, datë 28.10.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “ Për një ndryshim në VKB Nr 100, datë 29.12.2023 “Për Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024”, i ndryshuar”.

Z.Endri Hyseni – Është një projektvendim, që vjen në vijim të krijimit të Shoqërisë “Vlora Parking”.

Z.Kozma Mali – Ky projektvendim ka të bëjë me miratimin e vlerës financiare prej 3.5 milion lekë, kapital të Shoqërisë “Vlora Parking”. Do të hiqet nga zëri, prokurim i rrugës së Fshatit Drithas, fond i kursyer dhe, do kalojë për kapitalin e Shoqërirë “Vlora Parking”.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ka pyetje ?

-Jo.

Kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 27 vota / **26 vota**

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

V.O: Mbas diskutimit të pikës 5 të rendit të ditës, “Raport i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën Janar – Gusht 2024”, zonja Elpinqi Mërkuri/Kryetare e këshillit bëri një sqarim:

-Në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës, gjatë votimit, nuk ishin 27 vota, pasi zonja Bezhani erdhi më vonë. Pra 26 vota -Pro.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 13/6, datë 28.10.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës “Raport i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën Janar – Gusht 2024”. Kush e do fjalën ?

Znj.Elca Bezhani – Lidhur me raportin e monitorimit dhe zbatimit të buxhetit për periudhën janar – gusht 2024, e kam lexuar me vëmendje. Ekonomia është një shkencë,që merret jo vetëm me numrat, por dhe me analizën e numrave. Duhet të mbështetemi edhe tek Ligji “Për menaxhimin financiar ...”, Nr 9936/2008 ka nene që administrata bazuar në këto të raportojë.

-Neni 1 dhe 2, citon objektin dhe fushën e zbatimit..

-Neni 15, kopetencat..

-Neni 32 , përgatitjen e buxheteve vendore ..

-Neni 47, rishikimin e buxhetit ..

-Neni 48 , afatin për rishpërndarjen e fondeve..

Unë kam disa rekomandime dhe vërejtje në lidhje me këtë raport;

Në raportin 4 -mujor, kam thënë që, administrata të ndezë motorët. Nga analiza pashë disa mangësi. Mbledhja e komisionit të financës nuk u bë për shkak të mungesës së kuorumit, përfaqësuesit e administratës , ishin prezentë dhe kemi diskutuar .

- Lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet . Shqetësim, niveli i realizimit të të ardhurave nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Drejtoria e Urbanistikës janë të ulëta, rreth 19%.

Investimet çalojnë. Administrata ka pas justifikime në lidhje me procedurën e prokurimeve .

Por , mos të lihen për momentin e fundit, datën 15 Tetor, pra, që të rrinë pa bërë asnjë investim deri në muajin Tetor.

Në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore ka disa zëra që janë tejkaluar. Ne duhet të realizojmë ato që kemi miratuar në buxhet.

Tarifa e tregut – 122%

Tarifa e pastrimit, gjelbërimit – 101%

Taksë tabelle +taksë reklame – 103%...

Nuk mund të themi tejkalim . Ligji i menaxhimit dhe i kontrollit ...Është njësoj sikurse planifikojmë keq, po ashtu dhe kur shpenzojmë keq. Ekonomia është shkencë.

Me ndryshimet në Paketën Fiskale, nuk kemi taksim për dhomë, por taksim për person. Strukturat akomoduese janë rritur, sikurse dhe realizimi i taksës së fjetjes në hotel.

Tarifa e tregut , kemi shtim të numrit të bizneseve në treg.

Nga analiza e gjithë drejtorive të tjera...

Taksa e tokës bujqësore, realizuar në masë shumë të vogël 26%..Është me vlerë të realizimit...

-A është bërë ndonjë analizë nga njësitë administrative që, kjo taksë nuk është mbledhur?

-A kanë përdorur mekanizma të tjerë për mbledhjen e kësaj takse?

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhurat nga qiratë ...Ka nënshkruar disa kontrata..Vlera e kësaj tarife , është mbledhur në masën 2%.

Kjo ka një eksperiencë 10-vjeçare që nuk mblidhet dhe nuk kanë bërë analizë.

-Tarifa e pastrimit, DAV ka llogaritur realizimin për bizneset. Kemi agjent tatimor për mbledhjen e taksës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit për qytetarët.

-Çfarë bën Sh.A.Ujësjiellësi , a e mbledh këtë taksë ? Si është bërë ? Ndonjë marrëveshje ?

-Lekët që i ka borxh Bashkisë Vlorë, që mbledh si agjent tatimor. A ka ndonjë marrëveshje , në lidhje me shlyerjen e borxhit? Mënyrën dhe mundësinë ti gjejnë vetë.

Janë taksat e qytetarëve ..

-Taksa e plazheve..

Nga Drejtoria e Aseteve që mbledh dhe llogarit taksën për plazhet ..

-Doja të dija , sa kontrata janë lidhur dhe sa janë të ardhurat nga këto plazhe ?

-Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka disa sektorë që menaxhon. DBNJ, nuk duhet të merret vetëm me punësimet, por dhe me vlerësimin e punonjësve, çdo 6-mujor , për realizimin e objektivave që kanë patur. Njerëzit duhet të vihen përballë punës, detyrave.

Ky raport duhet të kishte ardhur që në muajin Shtator.

Ne si këshilltarë japim detyra . Unë shikoj predispozicionin e Kryetarit të Bashkisë për të suportuar administratën.

Drejtorët duhet të punojnë. Bëhet dëgjese publike, merren kërkesat dhe ti vënë në dispozicion të punës së tyre. Personat e terrenit punojnë. Duhet të jemi të kujdesshëm, nuk duhet ti lëmë gjërat për në momentin e fundit. (Bashkëlidhur relacioni)

Z.Ervis Moçka – Është raport monitorimi. Kryetare e komsionit e përmbodhi të gjithë punën e drejtorive. Është mirë që drejtorët të marrin rekomandimet e zonjës Bezhani dhe ti zbatojnë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ka pyetje, diçka tjetër ?

-Jo.

Ky është raport monitorimi, nuk votohet.

Një sqarim për një lapsus, në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës. Gjatë votimit nuk ishin 27 vota, pasi zonja Bezhani erdhi më vonë. Ishin 26 vota, pro.

Faleminderit për ditën e sotme.